


MANUAL për qytetarët

GATISHMËRIA 72

Bazat e gatishmërisë
së qytetarëve



Impresum

Titulli:

Manual për qytetarë - Gatishmëria 72 -
Bazat e gatishmërisë së qytetarëve

Autor:

Vasko Popovski

Botues:

Instituti për Demokraci
“Societas Civilis” - Shkup

Përkthyer nga:

Vjosa Taipi

Dizajni:

Vlado Srbinoski

Publikimi mund të shkarkohet falas në:

idscs.org.mk


Ky publikim financohet nga UK aid nga Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar. Qëndrimet e përmendura nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet dhe politikat zyrtare të Qeverisë Britanike.

MANUAL për qytetarët

GATISHMËRIA 72

Bazat e gatishmërisë së qytetarëve

version i shkurtuar¹



1. Procedurat më të detajuara për këto lloj fatkeqësi, si dhe për parandalimin dhe trajtimin e pandemive, temperaturave të larta dhe valëve të të nxehtit dhe fatkeqësive tekniko-teknologjike mund të gjeni në versionin e plotë të manualit në linkun e mëposhtëm.

PËRMBAJTJA

6

HYRJE

8

UDHËZIME TË PËRGJITHSHME PËR
GATISHMËRINË E QYTETARËVE

14

PLAN PËR SITUATA EMERGJENTE

16

LARGIMI I SHPEJTË NGA OBJEKTI
DHE EVAKUIM

21

KOMPLET PËR SITUATA
EMERGJENTE

Gatishmëri per

25

TËRMET

39

PËRMBYTJE

47

ZJARRI

59

MOTI I FTOHTË DHE RRESHJET
E BORËS

69

STUHI ME BRESHËR DHE
VETËTIMA

75

RRËSHQITJE TOKE

80

KONTAKTI ME INSTITUCIONET
KOMPETENTE

82

SHTOJCA 1 - PLANI PËR SITUATA
EMERGJENTE

90

SHTOJCA 2 - DOKUMENTAT
E IDENTIFIKIMIT DHE
DOKUMENTACIONI PRONËSOR

HYRJE

Profili i rreziqeve në Republikën e Maqedonisë së Veriut përbëhet nga rreziqe natyrore dhe të shkaktuara nga njeriu, siç janë: vërshimet, tërmetet, temperaturat ekstreme, stuhitë e përcjella me breshër, thatësira, rrëshqitjet e dheut, epidemitë dhe incidentet dhe fatkeqësitë tekniko-teknologjike. Më të shpeshta janë përmbytjet me intensitetin dhe magnitudën më të lartë, ngjarjet që kanë të bëjnë me kushtet atmosferike janë në rritje me magnituda më të mëdha, zjarret në pyje janë duke u rritur në frekuencë dhe me pasoja për natyrën dhe biodiversitetin, ndërsa tërmetet kanë ndikimin më të madh potencial mbi vendin dhe qytetarët e tij në kuptimin e humbjeve të jetëve dhe dëme dhe humbjeve afatgjata për shoqërinë dhe komunitetet lokale. Ky profil pasohet nga pandemia KOVID-19, në të cilën shoqëria, komunitetet lokale dhe individët janë prekur në mënyrë të paprecedentë, duke ulur seriozisht rezistencën e tyre dhe duke rritur cenueshmërinë dhe pabarazitë në shoqëri.

Qytetarët janë aktorë aktivë në reduktimin e rrezikut nga fatkeqësitë dhe janë të përfshirë si pjesë e sistemit të mbrojtjes dhe shpëtimit² dhe marrin pjesë në zbatimin e masave dhe aktiviteteve të mbrojtjes dhe shpëtimit.

Qytetarët duhet të jenë të vetëdijshëm dhe të përgatitur për t'u përballur me emergjencat dhe fatkeqësitë në suazat e njohurive dhe aftësive të tyre.

Ligji për mbrojtje dhe shpëtim përcakton më saktë detyrimet dhe përgjegjësitë e qytetarëve dhe ata kanë këto të drejta dhe obligime në ushtrimin e mbrojtjes dhe shpëtimit në Republikë:

- ▶ të marrin pjesë në mbrojtje dhe shpëtim;
- ▶ të kryejnë detyrimin material dhe të aftësohen dhe përgatiten për vetëmbrojtje;

2. Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë. Tekste të pastuara editoriale. Ligji për mbrojtje dhe shpëtim (tekst i konsoliduar). Neni 4. http://www.dzs.gov.mk/public/storage1/files/zakon_2.pdf.

UDHËZIME TË PËRGGJITHSHME PËR GATISHMËRINË E QYTETARËVE

Qytetarët duhet të jenë gjithmonë të përgatitur për t'iu përgjigjur një ngjarjeje emergjente ose katastrofike, e cila rrit shanset për menaxhim dhe rikuperim të suksesshëm. Pjesëmarrja në mbrojtjen, gatishmëria dhe menaxhimi me rreziqet nuk është vetëm përgjegjësi e institucioneve, por edhe e qytetarëve, të cilët përmes një qasjeje proaktive kontribuojnë ndjeshëm në rezistencën e tyre dhe të komunitetit.

Qytetarët janë ata që e njohin më mirë komunitetin dhe mjedisin e tyre dhe mund të japin një kontribut të rëndësishëm në mbrojtjen personale dhe kolektive.

Në rast të një ngjarjeje emergjente ose katastrofike në mjedisin tuaj, forcave të mbrojtjes dhe shpëtimit dhe burimeve të tjera lokale dhe kombëtare mund tu nevojiten deri në 72 orë për t'ju kontaktuar dhe për t'ju shpëtuar. Prandaj është e nevojshme që qytetarët të jenë të gatshëm për mbrojtje dhe ballafaqim me ngjarjen dhe situatën, të paktën në këtë periudhë kohore.

Qëllimi i këtij manuali është të japë këshilla dhe rekomandime për parandalimin, përgatitjen, reagimin dhe rikuperimin nga rreziqet natyrore dhe incidentet dhe aksidentet tekniko-teknologjike ekzistuese në vend.

Hapat

1

Njohuri për kërcënimet dhe rreziqet në mjedisin e afërt

- ▶ Informacionet për kërcënimet dhe rreziqet në zonën tuaj mund të merret nga komuna juaj, qendrat rajonale për menaxhim me kriza ose njësitë rajonale të Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim, si dhe nga degët e Kryqit të Kuq.
- ▶ Secila njësi e vetëqeverisjes lokale sjell vlerësime për rrezikshmërinë në hapësirën e komunave dhe qytetit të Shkupit nga të gjitha kërcënimet dhe rreziqet dhe vlerësime për rrezikimin e komunave dhe qytetit të Shkupit nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësi të tjera.

2

Përgatitja planore

- ▶ Përgatitja e dokumentacionit planor, njohja me procedurat, procedurat dhe teknikat për mbrojtje dhe vetëmbrojtje. Nga komuna juaj inicioni aktivitete ushtrimi sipas planeve të përgatitura dhe për skenarë të ndryshëm për përballimin e rreziqeve ekzistuese.

3

Kultura e gatishmërisë

- › Njihuni me planet për gatishmëri në organizatën tuaj të punës ose institucionin arsimor të fëmijëve tuaj dhe anëtarëve të komunitetit. Sa herë që vizitoni një objekt të ri, kur udhëtoni dhe qëndroni në një hotel ose merrni pjesë në një ngjarje kulturore, sportive ose ndonjë ngjarje tjetër, njihuni me korridoret për t'u larguar shpejt nga objekti, mendoni se si do të reagonit në rast tërmeti ose zjarri dhe ku do të ishit strehuar.

4

Lidhuni me komunitetin tuaj lokal, fqinjët, miqtë

- › Gjatë **72 orëve** të para komunitetit i kërkohet të përdorë të gjitha burimet për t'u ballafaquar me përgjigjen fillestare ndaj një emergjence ose gjendje katastrofe. Nëpërmjet rrjeteve sociale, në rast të një ngjarjeje katastrofike, do të ndani më mirë informacione dhe do të keni komunikim të rregullt.

5

Informim i rregullt

- › Informohuni për kushtet në mjedisin tuaj, rreziqet e mundshme, rreziqet dhe kërcënimet.
- › Informohuni përmes ueb faqeve të organeve kompetente, komunës, shtypit ditor, televizionit dhe radios, aplikacioneve.

6

Njihuni me sistemin e njoftimeve dhe alarmit

- › Shenjat e alarmit janë sinjale që informojnë dhe alarmojnë popullatën nëpërmjet sirenavë të instaluar nga sistemet e alarmit. Të gjitha stacionet radiotelevizive, gazetët ditore, mediat elektronike (portalet) dhe operatorët e rrjeteve dhe shërbimeve publike të komunikimit elektronik përdoren për informimin e popullatës, me raportime dhe njoftime si dhe me thirrje telefonike, njoftime zanore apo dërgimin e mesazheve.
- › Pas transmetimit të sinjalit paralajmërues për rrezik, si dhe pas marrjes së një telefonate ose dërgimit të një mesazhi në celular dhe telefon fiks, aktivizoni pajisjet radiotelevizive dhe prisni njoftime dhe rekomandime nga Qendra për Menaxhim me Kriza dhe veproni në përputhje me rrethanat.

Gjatë transmetimit të shenjës së rrezikut nga fatkeqësitë natyrore dhe natyrore dhe fatkeqësi të tjera, veprimet e popullatës varen nga lloji i rreziqeve, duke përfshirë informimin e shërbimeve përgjegjëse për thirrje urgjente:

195

Qendra për
Menaxhim me Kriza

193

Njësitë territoriale
të zjarrfikësve

194

Ndihma mjekësore
urgjente

192

Policia ose

112

Numri i vetëm për
raste emergjente

7

Rezistenca financiare

- › Siguroni pronën, mobilet, pajisjet, sendet me vlerë nga dëmtimet nga fatkeqësitë natyrore ose dëme të tjera të paparashikuara. Të gjitha shoqëritë e sigurimit që operojnë në vend e kanë përfshirë në portofolin e tyre këtë lloj sigurimi.
- › Mbani me vete një sasi të caktuar parash në monedhë vendase dhe të huaj, para të imta, të cilat do t'ju lejojnë të kapërceni më lehtë ditët e para pas një ngjarjeje emergjente apo katastrofike.

8

Mbroni kafshët tuaja shtëpiake

- › Kafshët shtëpiake duhet të jenë pjesë e planeve përgatitore

Rekomandim horizontal: Përfshini anëtarët e komunitetit tuaj me aftësi të kufizuara në këto aktivitete, duke marrë parasysh nevojat dhe aftësitë e tyre, si dhe llojin e ndihmës dhe mbështetjes që ju nevojiten për të përballuar ngjarjen.

PLAN PËR SITUATA EMERGJENTE

Plani i emergjencës është një mjet që i mundëson qytetarit apo komunitetit të dokumentojë informacionet bazë, nevojat dhe masat për ballafaqim me ngjarjen, mënyrën e komunikimit. Rekomandohet që çdo familje të ketë një plan të tillë, sepse gjatë 72 orëve të para të ngjarjes është e nevojshme të zbatohen masat dhe procedurat për mbrojtje dhe vetëmbrojtje.

- › Përgatitja e planit duhet të jetë gjithëpërfshirëse, me pjesëmarrjen e të gjithë anëtarëve të komunitetit, ku të gjithë anëtarët kanë një rol specifik dhe janë të njohur me përmbajtjen e tij.
- › Ruhet në një vend lehtësisht të qasshëm në shtëpi, me të cilin janë njohur të gjithë anëtarët e komunitetit. Këshillohet që të keni një kopje digjitale të dokumentit, si dhe një kopje në çantën për raste emergjente dhe për çdo anëtar të komunitetit, veçmas.

- › Plani i emergjencës duhet të përditësohet rregullisht ose pas çdo ndryshimi në komunitet, sipas një ngjarje të caktuar ose pas skadimit të kohës, për shembull 2 vjet.
- › Plani i emergjencës përmban informacione dhe të dhëna për personat për kontakt brenda dhe jashtë zonës së prekur përmes të cilave anëtarët e komunitetit do të komunikojnë nëse ndaheshin dhe do të informojnë kontaktet për gjendjen dhe nevojat e tyre.
- › Plani i emergjencës përfshin gjithashtu një skicë dhe rrugë për t'u larguar shpejt nga shtëpia ose objekti. Gjithashtu përmban informacione mbi dokumentet e identifikimit dhe dokumentimin e pronës.
- › Për planin e emergjencës nuk ka përmbajtje të përcaktuar, kështu që struktura e tij e propozuar jepet si shtojcë, e cila mund t'ju ndihmojë në përgatitjen e tij.

LARGIMI I SHPEJTË NGA OBJEKTI DHE EVAKUIM

Largimi i shpejtë nga shtëpia ose objekti kryhet me qëllim që në një kohë sa më të shkurtër në mënyrë të organizuar dhe të trajnuar paraprakisht anëtarët e komunitetit të largohen dhe të drejtohen në vendin e sigurt të paracaktuar ose lokacion tjetër të sigurt.

Me pjesëmarrjen e të gjithë anëtarëve të komunitetit dhe në konsultim me profesionistët, nëse është e nevojshme, përcaktohet rrugën për largim të shpejtë dhe lokacion të sigurt.

- › **Nëse mundeni, përgatisni edhe skicë për largim të shpejtë në të cilët do të aplikoni rrugët e lëvizjes nga çdo dhomë, daljet, lokacionin për ruajtjen e planit të emergjencës, dokumentet e identifikimit, pronësinë dhe kompletin për raste urgjente.**

- › Dentifikoni disa lokacione që mund të jenë një vend takimi për komunitetin tuaj dhe praktikoni disa herë largimin e shpejtë nga shtëpia dhe qasjen drejt tyre, duke vënë në dukje çdo pengesë dhe zgjidhje ekzistuese dhe të mundshme për t'i kapërcyer ato.
- › **Nëse ka një person me aftësi të kufizuara në komunitetin tuaj ose me paaftësi fizike, identifikoni një anëtar të komunitetit që do ta ndihmojë atë të largohet shpejt nga objekti.**
- › Nëse keni një kafshë shtëpiake, sigurohuni që ajo të largohet shpejt nga objekti me ju.
- › Gjithmonë përpiquni të fikni furnizimin me energji elektrike, ujin, gazin, shkëputni pajisjet nga priza.
- › Mos u ktheni në shtëpinë ose objektin tuaj derisa organet kompetente nuk e lejojnë këtë veprim.

Një nga masat për mbrojtje dhe shpëtim të paraparë në Ligjin për mbrojtje dhe shpëtim nga institucionet kompetente është që të urdhërohet zbatimi i **masës për evakuim**.³

3. Gazeta Zyrtare e RM, nr. 101 nga 27.7.2010. Qeveria e Republikës së Maqedonisë. Urdhëresë për zbatimin e masës për mbrojtje dhe shpëtim - evakuimi i popullatës <https://tinyurl.com/64nsdzvm>

Me masën, popullata nga zona nga e cila kryhet evakuimi mund të evakuhet në një komunë tjetër. ***Evakuimi i popullatës në një komunë tjetër nuk duhet të rezultojë me ndërprerje në ushtrimin e kompetencave të saj.*** Evakuimi mund të jetë i plotë (evakuhet të gjithë qytetarët nga një zonë e caktuar) dhe i pjesshëm (një pjesë e caktuar e popullsisë që është më e rrezikuar). Kategori të caktuara të popullsisë që i nënshtrohen evakuimit janë: fëmijët deri në shtatë vjeç, gratë shtatzëna, nënat me fëmijë deri në shtatë vjeç, fëmijët deri në 14 vjeç pa prindër ose prindërit e të cilëve janë të angazhuar në mbrojtje dhe shpëtim, të sëmurë rëndë dhe persona të palëvizshëm.

Evakuimi mund të jetë nga 15 ditë në një vit. Institucion kompetent për zbatimin e masës për evakuimin e popullatës është Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim.

- ▶ Nëse evakuoheni duke përdorur mjet motorik, mbushni gjithmonë rezervuarin sapo të zbresë në gjysmë kapacitet. Njihuni me rrugët e evakuimit dhe informohuni për dendësinë e komunikacionit.
- ▶ Studioni rrugët alternative dhe mjetet alternative të evakuimit duke përdorur transport të organizuar.
- ▶ Nëse komuniteti juaj ose anëtarët e tij janë subjekt i evakuimit, informoni autoritetet për nevoja specifike mjekësore dhe nevoja të tjera. Merrni me vete kafshët tuaja shtëpiake

dhe nëse lokacioni i takimit ose vendi për pranim lejon akomodimin e tyre. Përndryshe, sigurohuni atyre ushqim për një periudhë kohore.

- ▶ Informoni kontaktet e përbashkëta në zonë dhe jashtë saj për evakuimin dhe vendndodhjen e vendit të takimit ose vend pranimit.
- ▶ Nëse keni kohë gjithmonë përpikuni të fikni furnizimin me energji elektrike, ujin, gazin, shkëputni pajisjet nga priza.
- ▶ Me vete merrni planin e urgjencës dhe dokumentacionin për identifikim dhe dokumentacionin e pronës, kompletin për raste emergjente dhe sendet me vlerë.
- ▶ Nëse evakuoheni në mënyrë të organizuar, ndiqni udhëzimet dhe këshillat e autoriteteve kompetente dhe nëse jeni evakuoheni vetë, informohuni për ngjarjet dhe rekomandimet më të fundit qoftë përmes rrjeteve sociale ose përmes radio pranuesit me bateri.
- ▶ Komunikoni rregullisht me kontaktet e përbashkëta dhe anëtarët e tjerë të bashkësisë familjare për gjendjen dhe vendndodhjen e tyre, në rast të ndarjes së komunitetit.
- ▶ Pas përfundimit të evakuimit, kthehuni në shtëpi ose objekt sapo të lejohet këtë veprim, organet kompetente.

- › Hyni në shtëpi me kujdes për shkak të mundësisë së lëndimit në varësi të llojit të rrezikut. Ndizni energjinë elektrike, gazin, ujin etj., vetëm pas miratimit të organeve kompetente.
- › Raportoni çdo dëmtim të dukshëm në shtëpi dhe pronë tek autoritetet.

KOMPLET PËR SITUATA EMERGJENTE

Çdo individ ose çdo komunitet shtëpiak duhet të ketë komplet për raste emergjente në shtëpi, që do të përmbajë bazat dhe sendet ushqimore që do t'i mundësojnë të përgatiten në rast urgjence ose fatkeqësie dhe t'i kalojnë më lehtë 72 orët e para.


Këshillohet që kompleti të mbahet në një vend të qasshëm në shtëpi ose në ndërtesë që do të sigurojë qasje të lehtë kur e largoheni shpejt. Duke pasur parasysh faktin se kompleti përmban produkte dhe sende ushqimore që kanë një jetëgjatësi të caktuar, është e nevojshme që rregullisht të kontrollohet dhe plotësohet kompleti. Përmbajtja e zakonshme është si më poshtë:

- ▶ Ujë - sasia e rekomanduar është dy litra ujë për person, në shishe 0.5 litra. Nëse keni kafshë shtëpiake, parashihni një sasi të përkatëse uji.
- ▶ Lëng ose pije vitaminash që treten në ujë, për tre ditët e para.

- › Ushqime që nuk prishen lehtë (ushqime të konservuara dhe të thara, biskota energjike etj.). Nëse keni kafshë shtëpiake, parashihni një sasi të mjaftueshme ushqimi.
- › Tableta - klor për dezinfektimin e ujit.
- › Thikë xhepi ose hapëse shumë funksionale për kanoçe.
- › Llambë baterie me bateri rezervë.
- › Shkrepëse / çakmak.
- › Radio pranues portativ me bateri me komplet bateri rezervë.
- › Një bilbil fryrëse për personin dhe për çdo anëtar të komunitetit.
- › Komplet maska KN95 për person (të paktën dy për çdo anëtar të komunitetit).
- › Komplet portativ për ndihmë të parë;
- › Terapia mjekësore dhe dokumentacion bazë mjekësor me diagnostikimin e sëmundjeve kronike dhe receta rezervë.
- › Medikamente pa recetë për dhimbje koke, diarre, alergji etj.
- › Aksesorët bazë për higjienë në tualet.
- › Aksesorë bazë për higjienën intime të grave.

- › Nëse është e nevojshme - gota rezervë dhe thjerrëza kontakti me tretësinë për larje.
- › Mjete speciale: pelena, qumësht pluhur, monitor për matjen e sheqerit në gjak, stilolaps për insulinë
- › Dokumentet e identifikimit (pasaportë, kartë identiteti, patentë shoferi, karta bankare)
- › Kopje e planit të evakuimit të komunitetit, listë e kontakteve dhe dokumenteve të tjera të komunitetit.
- › Komplet i rezervë i çelësave për shtëpi, automjet, hapësirë afariste dhe objekte të tjera.
- › Karikues celulari dhe bateri e rikarikueshme për të paktën dy karikime (10,000 mAh)
- › Sasi e vogël parash në bankënota më të vogla.
- › Harta gjeografike lokale.
- › Fletore dhe stilolaps.
- › Lojëra, letra dhe libra për fëmijë.

Kjo listë nuk është përfundimtare. Nëse personi ose komuniteti ka nevojë për artikuj shtesë, për shkak të nevojave specifike etj., është e nevojshme që ato të përfshihen si rezervë.



TËRMET

Zonat më të ekspozuara sizmike janë Pehçeva, Vallandova, Shkupi, Dibra dhe Ohër-Pogradec. Shkalla më e përdorur e tërmeteve është Shkalla Evropiane Makrosizmike - EMS-98 sipas së cilës tërmetet klasifikohen në 12 gradë. Ndjenja, ndikimi dhe magnituda e tërmeteve janë paraqitur në tabelën e mëposhtme. Tërmetet zakonisht zgjasin shumë pak, vetëm disa sekonda, por mund të zgjasin deri në një minutë. Vdekjet dhe lëndimet nga tërmeti më së shpeshti shkaktohen nga ndërtesat e shembura, objektet që bien, strukturat e shembura, shtyllat etj., xhamat e thyer, si dhe zjarret që ndodhin si pasojë e tërmeteve.

EMS-98 Intensiteti	Ndjenjë	Efektet e tërmetit	Magnitudë (vlera e përafërt)
I	Nuk ndihet	Nuk ndihet.	2
II	Mezi ndihet	Dridhjet i ndejnë vetëm disa persona që pushojnë nëpër shtëpi, veçanërisht në katet e sipërme të ndërtesave.	
III	I dobët	Dridhjet janë të dobëta dhe ndjehen në ambiente të mbyllura nga disa njerëz. Njerëzit që pushojnë ndejnë lëkundje ose dridhje të dobët. Dridhje e dukshme e shumë objekteve.	3
IV	Ndihet mjaftueshëm	Tërmeti është ndjerë nga shumë njerëz brenda, dhe nga pak njerëz jashtë. Disa njerëz janë zgjuar. Niveli i dridhjeve është me siguri shqetësues. Dritaret, dyert dhe enët dridhen. Objektet e varura lëkunden. Nuk ka dëmtime në ndërtesa.	

V	I fortë	Shumë njerëz e ndjejnë tërmetin brenda, shumë në të hapur. Shumë njerëz që flenë janë zgjuar. Disa vrapojnë jashtë. Pjesë të tëra të të gjitha ndërtesave dridhen. Shumë objekte lëkunden ndjeshëm. Enët dhe gotat trokasin. Dridhjet janë të forta. Objektet e varura bien. Dyert dhe dritaret hapen ose mbyllen.	4
VI	Me pak dëme	Ndihet nga të gjithë brenda dhe nga shumica jashtë. Shumë njerëz në ndërtesa janë të frikësuar dhe ikin jashtë. Objektet nga muret bien. Dëmtime të lehta në ndërtesa; për shembull, çarje të holla në suva dhe copa të vogla suvaje muri bien.	5
VII	Me dëme	Shumica e njerëzve janë të frikësuar dhe vrapojnë jashtë. Mobilet lëvizin dhe shumë objekte bien nga raftet. Shumë ndërtesa pësojnë dëmtime të vogla deri në mesatare. Çarje në mure; shembje e pjesshme e oxhaqeve.	5

VIII	Dëme të mëdha	Mobilet mund të përmbysen. Shumë ndërtesa pësojnë dëmtime: bien oxhaqet; në mure shfaqen çarje të mëdha dhe disa ndërtesa mund të shemben pjesërisht. Mund të ndihet nga njerëzit që drejtojnë makina.	6
IX	Shkatërrues	Monumentet dhe shtyllat bien ose deformohen. Shumë ndërtesa të zakonshme rrënohen pjesërisht, ndërsa disa shkatërruar plotësisht. Dritaret thyhen.	7
X	Shumë shkatërrues	Shumë ndërtesa shemben. Vihen re çarje dhe rrëshqitje të dheut.	7
XI	Shkatërrues	Shumica e ndërtesave shemben.	8
XII	Plotësisht shkatërrues	Pothuajse të gjitha ndërtesat shkatërrohen. Toka ndryshon.	

Këshillat e përgjithshme praktike për qytetarët për parandalimin e tërmeteve janë si më poshtë:

- › **Kërkoni projektimin bazë ose punën e projektimit të shtëpisë ose ndërtesës dhe identifikoni muret dhe shtyllat e brendshme mbajtëse, shënojini ato me ngjithëse dhe njoftoni anëtarët e komunitetit tuaj, në mënyrë që ata të dinë se ku të qëndrojnë në rast tërmeti. Gjithashtu, identifikoni hapjet e dyerve që kanë trarë mbi kornizë ose janë bërë nga kasa të forta.**
- › Inspektoni mobilet (raftet, dollapët, pasqyrat, pajisjet e ndriçimit, etj.) dhe pajisjet (elektro - sanitaret, ngrohësit, kondicionerët) në shtëpinë ose ndërtesën tuaj për t'i mbrojtur ato nga rënia ose lëvizja në rast tërmeti, fiksoni ato me pajisje këndore ose të ngjashme dhe bllokoni rrotat. Shtretërit duhet të vendosen larg dritareve ose mobileve të forta dhe pasqyrave. Vendosni sende më të rënda në raftet e poshtme dhe ruani sendet e brishta në dollapë të mbyllur. Mos ruani lëngje të ndezshme, kimikate pranë një burimi nxehtësie për të parandaluar zjarrin.
- › **Në përprthje me Planin për situata emergjente, shënoni rrugën e evakuimit. Mos vendosni mobile, pajisje ose pengesa të tjera mbi të.**

Praktikoni të largoheni shpejt nga shtëpia ose ndërtesa në rast tërmeti të paktën një herë në vit, duke përdorur teknikat e mbrojtjes nga tërmeti, mbrojtjes dhe vetë-mbrojtjes dhe matjen e kohës së reagimit. Përcaktoni lokacionin/ pikën e takimit në rast tërmeti që është në distancë mjaft e sigurt nga shtëpia ose objekti dhe nuk rrezikohet nga objektet që fluturojnë ose bien.

- ▶ Kryeni përforcim shtesë të oxhakut dhe strukturave të tjera dhe instalimeve të çatisë, për shembull antenave, si dhe tendave dhe strukturave të tjera mbi dhe rreth ndërtesës.
- ▶ Sa herë që vizitoni një objekt të jashtëm në një zonë sizmiki aktive, njihuni me planin e evakuimit dhe vendndodhjet ku mund të strehoheni në rast tërmeti.
- ▶ Duhet të keni parasysh se si pasojë e tërmetit do të ketë ndërprerje të energjisë, ujit, telekomunikacionit. Mund të përfshihen gjithashtu alarmet dhe instalimet kundër zjarrit. Mos u frikësoni për këtë.
- ▶ Mos përdorni ashensor ose shkallë për t'u larguar shpejt nga ndërtesa, qoftë gjatë një goditjeje ose pas një tërmeti, derisa të keni marrë informacion se është e sigurt.

Procedurat për mbrojtje në rast tërmeti

Shtrihuni, mbulohuni dhe prisni **(Drop, Cover and Hold on)**

- › Rregulli bazë është të qëndroni të qetë gjatë tërmetit, të mendoni racionalisht. Mos vraponi, mos dilni ose hyni në shtëpi ose objekt. Paniku mund të rezultojë në hapa të gabuar dhe efekte anësore të mundshme.
- › Nëse jeni në hapësirë të brendshme, qëndroni të qetë, uluni në dyshe me për të ruajtur qëndrueshmërinë e trupit, mbuloni kokën dhe qafën me duar ose me një jastëk për t'u mbrojtur nga objektet që bien. Zvarrituni deri te tryeza ose stoli më i afërt i fortë dhe fshihuni nën të, duke e mbajtur me njërin dorë. Nëse ka një mur ose tra të brendshëm mbajtës pranë jush, ose një derë me një tra mbi kornizë, ose një kornizë me kasë të fortë, qëndroni poshtë tyre, duke mbuluar kokën dhe qafën. Nëse nuk mund të gjeni një strehë të përshtatshme, zvarrituni deri te muri i brendshëm, në gjunjë dhe me shpinën nga muri duke mbuluar kokën dhe qafën. Nëse jeni në shtrat dhe nuk keni kohë për t'u strehuar, qëndroni në shtrat dhe mbuloni kokën dhe qafën si me jastëk ashtu edhe me duar. Nëse ka një llambadar ose llambë masive mbi shtrat, atëherë strehohuni pranë shtratit ose murit të brendshëm, duke

mbuluar kokën dhe qafën. Mos dilni në ballkon apo tarracë.

- ▶ **Personat me aftësi të kufizuara fizike ose në karrocë invalide**, është e nevojshme të bllokojnë rrotat, të përkuleni përpara, t'i mbuloni me jastëk, batanije jastëku dhe me duar kokën dhe qafën dhe të qëndrojnë të qetë derisa lëkundjet të ndalojnë. Nëse nuk mund ta bëjnë këtë vetë, ndihmoni këta persona nëse jeni pranë tyre.
- ▶ Nëse keni **kafshë shtëpiake**, mbajini pranë jush ose strehohuni nën një objekt të fortë ose një pjesë të një objekti.
- ▶ Në përgjithësi rekomandohet që të qëndroni larg mureve të jashtme, dritareve, dyerve, dollapëve, burimeve të nxehtësisë, p.sh. soba, pajisje masive elektro shtëpiake, pasqyra, llambadarë dhe ndriçues më të mëdhenj të varur, etj., të cilat mund të lëkunden ose lëviznin si pasojë e tërmetit.
- ▶ Nëse jeni në **shumëkatëshe** gjatë një tërmeti, zbatoni procedurat e listuara më sipër. Duhet të keni parasysh se ndërtesat e larta lëkunden për një kohë të gjatë si pasojë e tërmetit.
- ▶ Nëse jeni në **objekt publik**, strehohuni nën një tavolinë ose stol të fortë, ose qëndroni nën një mur mbajtës, tra, derë ose strehohuni pranë një muri të brendshëm, duke aplikuar teknika dhe procedura mbrojtëse. Mos dilni nga ndërtesa derisa lëkundjet

të ndalojnë. Nëse jeni në **dyqan për tekstil** ose veshje, afrohuni te karroca e blerjes, uluni në tokë me duar që mbulojnë kokën dhe qafën. Nëse jeni në **teatër, kinema ose sallë sportive**, uluni në dysheme para sedijes ose përkuluni përpara sa të mundeni, duke mbuluar qafën dhe kokën me duar. Nëse në momentin e tërmetit jeni në **qendër tregtare**, uluni në tokë me duart mbuloni qafën dhe kokën, larg dritareve prej xhami, kanaleve të ventilimit, rafteve të mëdha ose bilborde. Në të gjitha këto situata, përpiquni të qëndroni larg turmës së njerëzve që përpiqen të largohen në panik, nga ndërtesa. Nëse keni një fëmijë ose të rritur ose një person me nevoja të veçanta, mbajini për dore dhe qëndroni bashkë.

- ▶ Nëse jeni në vend të hapur, strehohuni në ambient të **hapur**, larg ndërtesave, strukturave, objekteve infrastrukturore dhe konstruksioneve, bilbordeve, shtyllave të ndriçimit ose pemëve të larta. Kini parasysh se si pasojë e tërmetit mund të bien oxhaqe, çati ose pjesë të strukturave të çatisë, antenave, fasadave, ulluqeve, dritareve etj. Sapo të jeni jashtë, uluni në tokë, mbroni kokën dhe qafën me duar, çantë ose objekte të ngjashme dhe kini kujdes nga objektet që fluturojnë ose bien.
- ▶ Nëse jeni në **automjet**, ndaloni lëvizjen, parkoni në anën e djathtë të rrugës, nëse është e sigurt. Mos qëndroni nën nënkalime, ura, pranë ndërtesave dhe objekte të tjera, shtylla dhe struktura, bilborde

apo pemë të mëdha. Fikeni motorin, ngrini frenën e parkimit, aktivizoni katër sinjalet e dritës, hiqni rripin e sigurimit dhe ndizni radion për të dëgjuar informacionet më të fundit për ngjarjen. Nëse jeni në **autobus, tren ose mjete të tjera të transportit publik**, mbahuni fort për dorezat.

Procedura për shpëtim nga rrënojat

- ▶ Nëse jeni bllokuar në rrënojat e një shtëpie apo ndërtese si pasojë e një tërmeti, gjëja më e rëndësishme është të qëndroni të qetë dhe të vetëdijshëm. Mundohuni të zbuloni pozicionin tuaj aktual, duke u orientuar në hapësirën e caktuar. Gjatë kësaj, mos lëvizni për të mos shkaktuar lëvizjen e rrënojave dhe strukturës së dëmtuar të ndërtesës.
- ▶ Mbuloni hundën dhe gojën me shami dore ose një copë leckë ose veshje për të parandaluar hyrjen e pluhurit. Mos ndizni çakmakun ose shkrepësen.
- ▶ Nëse keni bilbil fryrës, fishkëlleni sa me zëshëm. Nëse keni komunikim celular dhe keni një pajisje celulare, dërgoni një mesazh ose telefononi kontaktin, mikun tuaj ose 195 (112) për të raportuar gjendjen tuaj.
- ▶ Nëse jeni të shtypur nga materiali ndërtimor, hiqeni me kujdes dhe kini kujdes që të mos lëndoheni më

tej. Nëse shihni një dalje të mundshme, vlerësoni situatën, përpiquni të dilni pa lëvizur pjesët e rrëzuara të strukturës, në mënyrë që të mos ndodhin rrënime të mëtejshme.

Pas tërmetit

- ▶ Pas goditjes së parë, **është e zakonshme që të pasojnë më shumë pasgoditje** gjatë një periudhe prej disa minutash deri në disa ditë ose javë rresht. Këto lëkundje janë në funksion të qetësimit të tokës, por gjithsesi mund të shkaktojnë panik, lëndime dhe dëmtime dhe për mbrojtjen dhe shpëtimin zbatohen teknikat dhe procedurat e mësipërme.
- ▶ **Qëndroni në vendstrehimin me mbrojtje të kokës dhe qafës derisa të ndalet lëkundja e tokës. Sapo të ndalojnë, numëroni deri në 30, vendosni maskën mbrojtëse për frymëmarrje KN95 dhe merrni kompletin për situata emergjente dhe dokumentet e identifikimit dhe dokumentacionit të pronës, nëse i keni me vete, fikni rrymën, gazin, ujin, telekomunikacionin.**
- ▶ **Gjatë largimit nga shtëpia apo objekti, përparësi kanë nënat me fëmijë, të moshuarit, të sëmurët, personat me aftësi të kufizuara dhe shoqëruarit e tyre. Sigurohuni që kafshët tuaja**


shtëpiake të largohen nga shtëpia ose objekti me ju. Kur largoheni, mbani një distancë të sigurt prej tij duke u mbledhur në një hapësirë të hapur, pikë grumbullimi ose vend tjetër të sigurt dhe kini kujdes nga objektet që fluturojnë ose bien.

- ▶ **Mundohuni të lidheni me anëtarët e komunitetit tuaj dhe informoni personin e përbashkët të kontaktit duke treguar statusin dhe vendndodhjen tuaj në rast se jeni ndarë nga anëtarët e komunitetit. Pas lëkundjes së parë, në shumicën e rasteve, linjat e telekomunikacionit ndërpriten, ndaj tregohuni të durueshëm dhe nëse vendosni kontakt, flisni në intervale të shkurtra. Nëse jeni në kontakt me të gjithë anëtarët dhe jeni në të njëjtën zonë, takohuni në vendin e caktuar. Nëse një anëtar nuk është i disponueshëm ose nuk dihet gjendja e tij/saj, njoftoni organet kompetente dhe organizatën komunale të Kryqit të Kuq.**
- ▶ **Shmangni përdorimin e automjetit tuaj në mënyrë që të mos pengoni punën e organeve kompetente. Megjithatë, nëse tërmeti ju kapi në automjet, vlerësoni gjendjen e terrenit dhe vetë infrastrukturës rrugore ose ngeçje të mundshme në aksin rrugor. Vazhdoni lëvizjen sipas planit nëse është e mundur. Shmangni ndalimin dhe kini parasysh se infrastruktura rrugore mund të shembet, mund të ndodhin rrëshqitje dheu përgjatë rrugës dhe mund të**

dëmtohen shenjat rrugore horizontale dhe vertikale.

- ▶ Mos u ktheni në shtëpi ose objekt pa lejen e autoriteteve nëse mund të vërehen dukshëm çarje dhe dëmtime ose ndërprerje të infrastrukturës komunale. Bëni fotografi të infrastrukturës. Kërkoni vlerësim të shpejtë të objektit, dhe në rast të dëmeve të mëdha raportoni dëmin tek komisioni komunal për vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe kompaninë e sigurimit në rast se keni policën e saj të sigurimit nga tërmeti.
- ▶ Nëse objektet dëmtohen ndjeshëm dhe nuk ka mundësi për qëndrim, atëherë organet kompetente do të organizojnë evakuimin e popullatës me vendosjen e tyre në një vend të sigurt të paracaktuar. Nëse ndjeni nevojën, kërkoni ndihmë psiko-sociale nga profesionistët e Kryqit të Kuq.
- ▶ Në eliminimin e pasojave, shërbimet dhe forcat për mbrojtje dhe shpëtim të subjekteve që marrin pjesë në mbrojtjen dhe shpëtimin nga rrënojat, mund të angazhohen dhe shfrytëzohen për kryerjen e lehtësimit në terren, pastrimin e rrënojave, shuarjen e zjarreve, RHB dekontaminim dhe veprimtari të tjera të kushtëzuara nga pasojat.⁴

4. Gazeta Zyrtare e RM, nr. 100 datë 23.7.2010. Qeveria e Republikës së Maqedonisë. Urdhëresë për zbatimin e masës mbrojtje dhe shpëtim nga rrënojat.



PËRMBYTJE

Këshilla dhe masa të përgjithshme për mbrojtjen nga përmbytjet

Nëse shikoni profilin e rreziqeve në vend, do të shihni se përmbytjet janë rreziku numër një sipas shpeshtësisë, intensitetit dhe pasojave të tyre në shtet dhe popullatë. Komunitat dhe Qyteti i Shkupit janë përgjegjës për mbrojtje nga vërshimet dhe efektet e tjera të dëmshme të ujit në zonat urbane, ndërsa jashtë tyre janë subjektet juridike që menaxhojnë me ekonomitë ujore, duke përfshirë rregullimin dhe mirëmbajtjen e shtretërve të lumenjve dhe kanaleve në zonën e tyre.⁵

Çfarë duhet të bëni për të mbrojtur veten:

- ▶ Informohu për rrezikun e përmbytjeve në mjedisin tuaj, veçanërisht nëse jetoni në zona fushore pranë shtretërve të lumenjve ose përrenjve, kanaleve për ujitje dhe kullimin e ujit, në brezat bregore të liqeneve dhe rezervuarëve ose në rrjedhën e poshtme të digave dhe rezervuarëve.

5. Ligji për ujërat - tekst jozyrtar i konsoliduar. Nenet 122, 124, 126, 132, 141, 143. <https://tinyurl.com/58xwtmfp>

- ▶ **Njihuni me hartat e rrezikut nga përmbytjet që mund të gjenden te organet kompetente (komunat, qendrat rajonale për menaxhim me kriza ose zyrat rajonale të Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim; Në pajtim me valën e përmbytjeve dhe shkallën e rrezikut nga përmbytjet, planifikoni zbatimin e masave të duhura për mbrojtje.**
- ▶ Shmangni ndërtimin e strukturave të reja në zonat në rrezik nga përmbytjet dhe forconi ato ekzistuese për mbrojtje nga përmbytjet.
- ▶ Siguroni pronën tuaj nga rreziku i përmbytjeve.
- ▶ Kërkoni shënuesit e valëve të përmbytjeve në afërsinë tuaj dhe mësoni rreth udhëzimeve për evakuim të sigurt dhe në kohë dhe pikat e grumbullimit në zonën tuaj në rast përmbytjeje.
- ▶ Nëse shtëpia ose ndërtesa juaj është në zonën e përmbytjes ose është në rrezik përmbytjeje, nëse është e mundur ndërtojeni në një themel të ngritur ose nëse është në dy ose më shumë kate, lëvizni sendet me vlerë, pajisjet në katin e sipërm. Gjithashtu, mos ruani sende ose pajisje në bodrum.
- ▶ Nëse jetoni në objekt individual, merrni materiale nga të cilat mund të bëni mbrojtje të përkohshme nga valët e ujit, si qese plastike, rërë, trungje, tokë për argjinaturat. Nëse përmbytja është e

pashmangshme dhe vjen, mos vendosni qese mbrojtëse rreth shtëpisë në mënyrë që të mos ushtroni presion shtesë mbi muret dhe strukturën. Lëreni ujin e përmytjes të lëvizë lirshëm dhe të vërshojë bodrumet në mënyrë që të barazohet presioni i strukturës së ndërtesës.

- ▶ Parandaloni rrjedhën e kthimit të ujit, veçanërisht në kanalizime duke instaluar valvola moskthimi dhe instalime të ngjashme.
- ▶ **Mos hidhni mbeturina dhe sende në shtretër lumenjsh, përrenj, kanale, puseta dhe në kanalizimin atmosferik, sepse në rast përmytjeje, bllokimi i tyre mund të sjellë pasoja të rënda për jetën dhe pronën e qytetarëve.**
- ▶ **Pas marrjes së një njoftimi për përmytje ose në rast të një përmytjeje të afërt, largohuni menjëherë nga ndërtesa në mënyrë të organizuar ose, nëse nuk jeni në gjendje ta bëni këtë në mënyrë të sigurt për shkak të nivelit të ujit, strehohuni në katin e sipërm ose në çati. Mbani gjërat me vlerë lart si dhe kafshët shtëpiake.**
- ▶ Nëse ende jeni në ndërtesë, veçanërisht duhet të jeni të kujdesshëm gjatë natës. Organizimi i kujdestarisë për monitorimin e gjendjes me përmytjen dhe njoftimet e autoriteteve kompetente.


- ▶ Nëse jeni në katet e sipërme dhe telefoni juaj celular funksionon, njoftoni autoritetet lokale për vendndodhjen tuaj në 195 (112) ose kontaktoni personin e kontaktit.
- ▶ Nëse jeni jashtë, strehohuni menjëherë në një vend më të lartë. Nëse jetoni në fshat, strehoni kafshët shtëpiake dhe bagëtinë tuaj në vend më të lartë dhe nëse kjo nuk është e mundur, lërini të lirë.
- ▶ Në rast evakuimi të organizuar, ndiqni rrugët që ju janë dhënë dhe mos u largoni prej tyre. Nëse ecni, mos kaloni nëpër ujëra në lëvizje, sepse edhe uji me thellësi 15 cm mund t'ju rrëzojë në tokë.
- ▶ Nëse evakuoheni me automjet, ndiqni rrugën e caktuar dhe jini të vetëdijshëm për rreziqet dhe sfidat gjatë evakuimit. Mos drejtoni automjetin në zona të përmytura ose nëpër ujë të thellë, pasi jo vetëm që kjo mund të shkaktojë ndalimin e motorit, por një thellësi prej 30 cm mund të dëmtojë seriozisht qëndrueshmërinë e automjetit dhe të shkaktojë rrëshqitje ose të marrë me vete automjetin.

Pas përmbytjes

Nëse jeni larguar nga shtëpia ose objekti ose jeni evakuuar në mënyrë të organizuar, mund të ktheheni vetëm nëse është e sigurt dhe e lejuar nga autoritetet.

- ▶ Nëse jeni larguar nga shtëpia ose objekti ose jeni evakuuar në mënyrë të organizuar, mund të ktheheni vetëm nëse është e sigurt dhe lejohet nga autoritetet. Kujdes gjatë lëvizjes pasi infrastruktura rrugore mund të jetë e dëmtuar.
- ▶ Inspektoni vizualisht objektin dhe pronën, si dhe sendet në të dhe nëse vini re dëmtime të dukshme, fotografojini ato për të shërbyer si shtojcë ndaj raportit për dëmet. Në rast të dëmeve dhe pasojave të mëdha, raportoni dëmin tek Komisioni Komunal për Vlerësimin e Dëmeve nga Fatkeqësitë dhe tek kompania e sigurimit në rast se keni një polic sigurimi që mbulon rrezikun nga përmbytjet.
- ▶ Sapo të hyni në objekt, kini kujdes për kabllot elektrike të rënë dhe dëmtime të tjera.
- ▶ Kontrolloni lidhjet me infrastrukturën komunale dhe në rast ndërprerje njoftoni ndërmarrjet komunale dhe operatorët.
- ▶ Mos përdorni pajisje elektrike nëse janë të dëmtuara ose në kontakt me ujin. Përdorini ato vetëm nëse shihni se janë të sigurta për t'u përdorur.

- ▶ Mund ta përdorni ujin nga sistemi i furnizimit me ujë vetëm pasi të keni marrë një njoftim se është i sigurt për t'u përdorur dhe pirë. Nëse keni puse, uji duhet të pompohet dhe të testohet për përdorim.
- ▶ Dysshemetë, muret dhe të gjitha sipërfaqet e tjera që kanë qenë në kontakt me ujin e përmytjes duhet të pastrohen dhe dezinfektohen tërësisht. Filloni pastrimin ndërsa sipërfaqet janë të lagura, pasi mjafton që mikroorganizmat të rriten në sipërfaqet e lagura brenda 48 orëve. Gjatë pastrimit është e nevojshme të vishni veshje mbrojtëse (maskë për hundë dhe fytyrë, doreza, çizme gome).
- ▶ Përfshihuni në punën e vullnetarëve që organizojnë aksione për pastrim dhe rikuperim nga përmytjet sa herë që është e mundur dhe ndihmoni bashkëqytetarët që kanë nevojë për ndihmën e duhur për rikuperim.
- ▶ Nëse ndjeni nevojën pas përmytjes, kërkoni ndihmë psiko-sociale nga profesionistët e Kryqit të Kuq.



ZJARRI

Zjarret në territorin e vendit manifestohen si zjarre të hapura, zjarre në pyje dhe zjarre në ndërtesa. Zjarret në natyrë janë më pak të zakonshmet dhe shpesh shndërrohen në zjarre pyjore.

Këshilla dhe masa të përgjithshme për mbrojtjen nga zjarri në amvisëritë dhe objektet

- ▶ Çdo familje apo organizatë duhet të marrë masa dhe aktivitete për mbrojtjen nga zjarri, qoftë si masa dhe procedura strukturore apo jo strukturore.
- ▶ **Është e nevojshme që në shtëpi ose në ndërtesë të ketë aparat përkatës kundër zjarrit, gjithashtu është e dëshirueshme që të ketë detektorë tymi ose alarme zjarri.**
- ▶ Nëse jetoni në një ndërtesë kolektive banesore me më shumë se katër apartamente, është e nevojshme të keni një “Rend të Shtëpisë për Zjarr”⁶, i vendosur në një vend të dukshëm në ndërtesë. Rendi i shtëpisë kundër zjarrit përmban: masat për mbrojtjen nga zjarri të përshtatshme për kushtet e jetesës dhe të punës në ndërtesë; organizimi i mbrojtjes nga zjarri; udhëzime për procedurën në rast zjarri.
- ▶ Rrjeti hidraulik për fikjen e zjarrit, duhet të jetë funksional dhe të testohet rregullisht. Përveç kësaj, çdo ndërtesë duhet të ketë mjete, pajisje (lopata, etj.), enë me rëre, etj. Një pjesë e ndërtesave shumëkatëshe, madje edhe disa nga ndërtesat më të ulëta kanë shkallë të

6. Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë. Tekste të pastruara editoriale. Ligji për mbrojtje dhe shpëtim (tekst i konsoliduar). Neni 79. http://www.dzs.gov.mk/public/storage1/files/zakon_2.pdf

jashtme për shpëtim nga zjarri dhe ato duhet të jenë funksionale ndërsa qasja dhe lëvizja përgjatë tyre nuk duhet të pengohet nga asnjë objekt dhe send.

- ▶ Niveli tjetër i parandalimit është përfshirja e rrezikut nga zjarri në policën e sigurimit të pronës.
- ▶ **Nëse në familjen tuaj ka një person me aftësi të kufizuara fizike në karrocë invalide, atëherë rregulloni rrugët e daljes sipas madhësisë së karrocës. Këshillohet që të keni batanije kundër zjarrit për të mbuluar fytyrën dhe karrocën për evakuim të sigurt.**
- ▶ Pastroni rregullisht bodrumet, tavanin dhe hapësirat ndihmëse, si dhe garazhet nga mbeturinat, gazetatat, materialet e ndezshme, mobile, goma etj. Mos ruani materiale të ndezshme në shtëpinë ose ndërtesën tuaj dhe nëse keni një sasi të kufizuar për përdorim, atëherë mbajini ato larg burimeve të nxehtësisë.
- ▶ Mos i mbingarkoni kabllot zgjatës me disa pajisje të lidhura menjëherë dhe përdorni kabllot zgjatës me siguresë. Kontrolloni rregullisht gjendjen e instalimit elektrik dhe zëvendësoni atë plotësisht ose pjesërisht dhe në shenjën më të vogël të dëmtimit. Hiqeni menjëherë nga priza dhe zëvendësoni pajisjet ndriçuese dhe llambat që janë të ngrohta në prekje ose lëshojnë shkëndije. Kontrolli i rregullt vlen edhe për ngrohëset.

- › Mos pini duhan në shtrat sepse mund të bini në gjumë, ndërsa duhani i pashuar i cigares mund të shkaktojë zjarr.
- › Investitori në dokumentacionin e projektit për ndërtimin e objekteve, si dhe për objektet që janë në rikonstruksion - ri përdorim është i detyruar të përgatisë një raport të veçantë për mbrojtje nga zjarret, shpërthime dhe substanca të rrezikshme.

Këshilla dhe masa të përgjithshme për mbrojtje nga zjarret në të hapur dhe zjarret në pyje

- › Mos hidhni cigare të ndezura ose bishtin e cigares në mjedise të hapura, mos digjni kashtë, bar ose bimësi, ose skarë në mjedise të hapura pranë pyjeve. Nëse punoni jashtë me mjete ndezëse, afër duhet të keni aparat KZ.
- › **Nëse jetoni në një ndërtesë të rrethuar nga pyll ose bimësi të bujshme (shtëpi, vilë, shtëpi në fshat, etj.) në policën e sigurimit të pronës, përfshini rrezikun nga zjarri.**
- › **Pastroni rregullisht zonën rreth shtëpisë tuaj në një perimetër prej 15 - 20 m rreth gardhit tuaj të jashtëm duke hequr degët e thata, gjethet e rënë dhe materiale të tjera të ndezshme.**

- › Përdorni materiale rezistente ndaj zjarrit për strukturën tuaj të çatisë (tjegulla rezistente ndaj zjarrit ose material tjetër për çati) dhe për fasadën e jashtme (stiropor vetë-fikës, etj.).
- › Nëse shtëpia apo ndërtesa juaj është larg qytetit, fshatit, lagjes urbane dhe afër pyllit, atëherë vendosni në oborr një rezervuar uji që do të mbushet me ujë nga ujësjellësi dhe me ujë shiu dhe ndër të tjera mund të përdoret për shuarjen e zjarrit.

Zjarret në shtëpi dhe objekte

- › Nëse vëreni zjarr në shtëpi ose objekt, telefononi menjëherë në numrin 193 (192) dhe me qetësi dhe në mënyrë të kuptueshme jepni informacionin bazë për ngjarjen: adresën, katin, hyrjen, banesën, numrin e personave, personat me aftësi të kufizuara etj. Lajmëroni anëtarët e komunitetit dhe fqinjët duke bërë titur zëshëm dhe largohuni shpejt nga shtëpia ose objekti.
- › Fikni furnizimin me energji elektrike dhe gaz, si dhe ngrohjen nëse mundeni. Nëse është kapluar një dhomë, mbylleni derën dhe përpikuni ta shuani me aparatit e shtëpisë kundër zjarrit. Zjarrin e instalimit elektrik asnjëherë mos e shuani me ujë. Megjithatë, nëse furnizimi me energji elektrike është i fikur, atëherë zjarri mund të fiket me ujë.

Zjarret nga vaji mund të shuhen me zbardhues, kripë ose duke mbuluar tenxheren e sobës. Nëse zgjerohet me shpejtësi, largohuni menjëherë nga shtëpia ose objekti, duke mbyllur dyert për të zvogëluar rrjedhën e oksigjenit në dhomë.

- ▶ Mos përdorni ashensorin nëse jetoni në ndërtesë shumëkatëshe. Gjithmonë dalja e parë le të jenë shkallët kundër zjarrit. Nëse nuk ka flakë në fasadë, dilni në ballkon ose tarracë, duke mbyllur derën pas për të parandaluar rrjedhjen e oksigjenit.
- ▶ **Nëse nuk jeni në gjendje të dilni nga banesa, vendosni peshqirë të lagur rreth derës dhe prisni që zjarrfikësit të vijnë.**
- ▶ Nëse rrobat tuaja janë në zjarr, ngrihuni, mbuloni fytyrën me duar, shtrihuni në tokë dhe kthehuni majtas e djathtas disa herë derisa zjarri të shuhet. Nëse një person tjetër është kapluar nga flaka, atëherë fikenit me pallto, peshqir, batanije ose material të ngjashëm, por asnjëherë me duar. Nëse ndodhin djegie, trajtojini ato me ujë të ftohtë për disa minuta dhe mbulojini me një leckë të pastër derisa të arrijë ndihma mjekësore urgjente.
- ▶ Pas përfundimit të zjarrit, mund të ktheheni vetëm pasi të lejojnë organet kompetente.
- ▶ Nëse ju lejohet të ktheheni, futuni me kujdes, duke pasur kujdes nga objektet dhe sendet që bien. Fotografoni hapësirat, bëni një inventar të asaj që

është dëmtuar ose shkatërruar. Raportoni dëmin tek kompania e sigurimit nëse keni policë sigurimi duke përfshirë sigurimin e rrezikut nga zjarri. Në atë rast mos i hidhni sendet e djegura dhe të dëmtuara, derisa në nuk përfundon inspektimi nga shoqëria e sigurimit.

Zjarret në natyrë dhe zjarret në pyje

- ▶ Zjarret në ambiente të jashtme dhe zjarret në pyje mund të ndodhin në disa mënyra: në mënyrë natyrale (nga rrufeja për shkak të ndezjes spontane nga thatësira ekstreme), mekanikisht (shkëndijat e linjave të energjisë elektrike) dhe si rezultat i aktivitetit njerëzor (djegia e kashtës, tokës së punueshme dhe vegjetacionit, shkëndija nga makineritë bujqësore dhe mekanizim tjetër, nga një cigare, ndezja e zjarrit në natyrë, djegia e qëllimshme e bimësisë dhe pyllit).
- ▶ Këto zjarre përhapen shpejt, veçanërisht nëse njëkohësisht fryn erë e fortë. Shuarja e tyre nuk është e lehtë, sidomos nëse digjet zonë e paarritshme kodrinore-malore. Përballja me to kërkon ndërhyrje afatgjatë me një numër të madh burimesh, pajisjesh dhe teknikash, duke përfshirë mbështetjen ajrore (aeroplanë dhe helikopterë).


- ▶ Nëse qëndroni në natyrë ose në pyll dhe vëreni tym ose zjarr, telefononi menjëherë 195 (112) dhe informoni ata për vendndodhjen tuaj, lokacionin e zjarrit, llojin e bimësisë, drejtimin e përhapjes, kushtet e motit dhe praninë ose mungesën e njerëzve në afërsi.
- ▶ Largohuni menjëherë nga terreni dhe shkoni sa më larg në një vend të sigurt. Nëse jeni në një kompleks pyjor me pishë ose zjarri ka prekur këtë lloj pylli, duhet të keni parasysh se boçet që digjen mund të fluturojnë deri në 2 km larg dhe të shkaktojnë një zjarr të ri.
- ▶ **Nëse jeni në një mjedis të hapur me zjarr dhe jeni të rrethuar nga zjarri, mos u përpiqni ta kapërceni atë, por nëse ka një trup ujqor afër, drejtohuni dhe futuni në të, sa më larg bregut. Nëse nuk ka trup ujqor afër, atëherë shtrihuni në tokë, hiqni pjesët metalike të veshjes, mbulohuni me tokë ose laguni me ujë dhe prisni sa të largohen flakët. Merrni frymë ulët në tokë përmes një shamie, leckë ose pëlhurë nga veshja juaj për të shmangur thithjen e tymit dhe ngufatjen. Mbajini sytë mbyllur dhe mos shikoni flakën. Sapo largohen flakët, largohuni me shpejtësi nga ai vend në një vend të sigurt, duke pasur kujdes se ku shkëlmi (ka copa prushi në tokë) dhe duke marrë frymë përmes shamisë, pëlhurës ose tekstilit nga rrobat.**

- ▶ Nëse shtëpia ose objekti juaj është në rrezik të drejtpërdrejtë nga një zjarr i hapur ose zjarri në pyll, atëherë hiqni të gjitha sendet e lëngshme dhe materialet e ndezshme sa më larg, fikni energjinë elektrike, gazin ose karburantin për ngrohje, merrni masa për të shuar zjarrin rreth perimetrit të pronës përkatësisht rreth gardhit, ujisni pemët, vegjetacionin dhe strukturat prej druri, nëse keni të tilla. Në objekt vendosni të gjithë anëtarët e komunitetit dhe kafshët shtëpiake. Mbyllni dritaret dhe dyert duke vendosur peshqirë uji rreth dritareve ose nën dyer. Hiqni perdet dhe largohuni nga dritaret, pasi nxehtësia mund të shkaktojë plasaritje të xhamit. Vendosuni në mes të dhomës dhe siguroni ujë dhe peshqirë ose peceta të lagura në ujë. Nëse keni pishinë, mund të përdorni ujin për të shuar zjarrin. Nëse keni automjet, mbajeni atë larg shtëpisë ose objektit tuaj.
- ▶ Nëse urdhërohet evakuimi urgjent i popullatës nga lokacioni juaj, merrni me vete kompletin për gjendje emergjente, dokumentet e identifikimit dhe dokumentacionin e pronës dhe sende të tjera me vlerë. Nëse komunikimi celular funksionon, telefononi personin e kontaktit dhe njoftoni për ngjarjen dhe vendin e evakuimit me kërkesë për të informuar anëtarët e tjerë të komunitetit ose të afërmit.
- ▶ Pas përfundimit të zjarrit, kushtojini vëmendje pikave të nxehta që mund ende të digjen, shuajini

dhe kini kujdes që të mos ndizen përsëri. Fillimisht, bëni kujdestari përreth ndërtesës për të vërejtur ndonjë zjarr të mundshëm dhe për të alarmuar dhe ndërhyrë në kohë. Nëse jeni evakuuar, kthehuni në shtëpi vetëm nëse këtë gjë e lejojnë autoritetet kompetente.

- ▶ Në rast dëmtimi, bëni fotografi dhe raportoni te komisioni komunal për vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe në kompaninë e sigurimeve nëse keni një polic të vlefshme sigurimi për rrezik nga zjarri.
- ▶ Kryetari i komunës në territorin e së cilës ka shpërthyer zjarri në shkallë të gjerë, në përputhje me planin për mbrojtje dhe shpëtim, me thirrje publike mund të ftojë qytetarët mbi 18 vjet që të marrin pjesë në aksionin e shuarjes së zjarrit, si dhe për të vënë në dispozicion mjetet dhe pajisjet e tyre.⁷ Qytetarët që kanë marrë pjesë në shuarjen e zjarrit me thirrjen e kryetarit të komunës kanë të drejtat që u takojnë zjarrfikësve vullnetarë për të marrë pjesë në shuarjen e zjarrit. Shpenzimet i bartë komuna në territorin e së cilës ka ndodhur zjarri.

7. Gazeta Zyrtare e RM, nr. 168 datë 21.11.2017. Ligji për zjarrfikës – tekst i konsoliduar. Nenet 39 dhe 40. https://www.dzs.gov.mk/public/storage1/files/zakon_3.pdf



MOTI I FTOHTË DHE RRESHJET E BORËS

Mbrojtje personale gjatë motit të ftohtë

- ▶ Temperatura në shtëpinë ose ambientet tuaja duhet të jetë nga 18 deri në 20 gradë, ndërsa një nga dhomat ose hapësirat duhet të jetë gjithmonë e ngrohur mirë.
- ▶ Pjesën më të madhe të kohës kaloni në shtëpi ose në vend të mbyllur me qëllim të tejkaloni ekspozimin e panevojshëm në temperaturë të ulët në vend të hapur. Kjo veçanërisht vlen për të sëmurët kronikë, fëmijët, të rriturit, personat me aftësi të kufizuara.
- ▶ Duhet të keni një radio me bateri (me komplet baterish shtesë) përmes së cilës mund të informoheni për situatën dhe të rehat në rast të ndërprerjes së furnizimit me energji elektrike.
- ▶ Mbani telefonat celularë dhe pajisjet e tjera elektronike me bateri të mbushur, gjithashtu siguronit një bateri / karikues shtesë për rimbushje.
- ▶ Kujdesuni për anëtarët më të cenueshëm të komunitetit tuaj, për shembull fëmijët, të moshuarit,

personat me aftësi të kufizuara, të sëmurët kronikë dhe të tjerë. Në kohë furnizohuni me medikamente, terapi mjekësore dhe terapi të tjera që janë të nevojshme për ju dhe për ta, për një periudhë të gjatë kohore ose mjete ndihmëse ortopedike dhe mjete të tjera.

- › **Kujdesuni për njerëzit më të rrezikuar në ndërtesën, lagjen, mjedisin tuaj. Pyetini nëse kanë nevojë për ushqim, ilaçe, ushqime, terapi. Moti i ftohtë dhe bora i pengojnë ata të lëvizin lirshëm dhe të plotësojnë nevojat e tyre themelore. Një grup veçanërisht i rrezikuar janë të pastrehët dhe për këtë arsye ju mund t'i ndihmoni duke u dhënë rroba të ngrohta, ushqim të duhur. Nëse vëreni person në rrezik nga moti i ftohtë (i pastrehë, fëmijë në rrugë, etj.), telefononi në numrin pa pagesë 15-505.**
- › Gjithashtu, muajt e dimrit janë muaj depresiv dhe ndjenjë vetmie. Ndaj bisedoni me ta për tema të ndryshme, qoftë me telefon apo në kontakt të drejtpërdrejtë gjatë çka do të respektoni masat për mbrojtje nga KOVID-19.
- › Për kafshët shtëpiake, përgatitni një pako me veshje për ngrohje, ushqim, si dhe terapi mjekësore dhe terapi të tjera nëse është e nevojshme.
- › **Përgatitjet për sezonin e dimrit në zonat rurale dhe malore janë pak më specifike se në zonat urbane. Ata shpesh mbulohen me sasi të**

mëdha të dëborës ose shiut dhe komunikimi rrugor dhe telefonik ndërpritet. Prandaj është e nevojshme të përgatiteni për të qenë plotësisht i pavarur në periudhën prej të paktën një javë. Siguroni ngrohje të mjaftueshme, ushqim, ilaçe dhe terapi mjekësore dhe produkte të tjera dhe përdorni ato në mënyrë racionale. Gjithmonë duhet të keni një person për komunikim i cili do të informohet për lëvizjen, udhëtimin tuaj.

- ▶ Duhet të jeni të përgatitur që në rast të temperaturave të ulëta, furnizimi me energji elektrike mund të ndërpritet. Prandaj është e nevojshme këtë periudhë ta kaloni në mënyrë të sigurt. Në zonat urbane këto ndërprerje zakonisht zgjasin shkurt, ndërsa në zonat rurale dhe zonat malore dhe fshatrat mund të zgjasin disa ditë.

Obligimet për veprim në rast të të ftohtit dhe reshjeve të borës

- ▶ Ministria e Shëndetësisë përgatit Plan Veprimi për parandalimin e pasojave nga valët e të ftohtit dhe në rast të shfaqjes jep rekomandime si të sillen qytetarët, si për shembull lirim nga përgjegjësitë e punës të grupeve më të rrezikuara të popullsisë, si gratë shtatzëna dhe të moshuarit mbi 60 vjeç organizimi i proceseve të punës në vende të hapura me turne gjatë periudhës së ngrohtë të ditës dhe

ngjashëm. Nëse është e nevojshme dhe në baza ditore, Komisioni për Parandalimin e Efekteve të Dëmshme nga Valët e të Ftohtit pranë Ministrisë së Shëndetësisë propozon masa dhe aktivitete për minimizimin e rreziqeve, veçanërisht për kategoritë e rrezikuara të qytetarëve.

- ▶ Komunat publikojnë rekomandime si të veprojnë qytetarët gjatë temperaturave të ulëta dhe valëve të të ftohtit. Së bashku me objektet shëndetësore dhe shtëpitë shëndetësore, shpesh organizojnë aksione për ekzaminime parandaluese dhe këshilla për mbrojtje nga valët e të nxehitit. Së bashku me organizatat komunale të Kryqit të Kuq organizojnë ndihmë për kategoritë më të rrezikuara të qytetarëve, si dhe për qytetarët në zonat vështirë të arritshme apo aksione për zhvendosjen e tyre në vendet më të ulëta të komunës. Organizatat komunale të Kryqit të Kuq mund të organizojnë aktivitete për të ndihmuar kategoritë e rrezikuara të qytetarëve, të pastrehët, si dhe shpërndarjen e çajit dhe pijeve të ngruhta.
- ▶ **Si qytetar keni obligim të pastroni borën para shtëpisë apo objektit tuaj afarist, si dhe nga çatia. Për parandalim hidhni kripë të veçantë në shtigjet dhe shkallët në lokacionin tuaj, si dhe në sipërfaqen para shtëpisë ose objektit tuaj, ndërsa në rast shiu të akullt dhe akull, hidhni rërë mbi to. Kushtojini vëmendje të veçantë paraqitjes së akullit në çati dhe ulluqe**

dhe përpikuni t'i hiqni ato. Nëse akujt janë më të mëdhenj dhe paraqesin rrezik, kontaktoni shërbimet komunale ose brigadën territoriale të zjarrfikësve.

- › Komuna ose në rastin e Qytetit të Shkupit, qyteti, ka obligim që në kushte dimërore gjatë reshjeve të borës t'i pastrojë rrugët, hapësirat publike dhe trotuaret, jo më vonë se 6 orë nga fillimi i reshjeve të borës. Të gjithë pronarët, përkatësisht shfrytëzuesit e objekteve publike - lokale, dyqane, pompa karburanti, toka dhe hapësira për manifestime publike dhe objekte të ngjashme kanë për obligim që të pastrojnë borën në hapësirat e hapura para tyre, me çka do të sigurohet qasje të papenguar në objekte. Nëse personat juridikë dhe fizikë nuk veprojnë në përputhje me dispozitat ligjore, heqja dhe pastrimi i borës mund të jetë në shpenzim të tyre dhe do të kryhet nga personi juridik me të cilin është lidhur kontrata për pastrim, ndërsa të pa shmangshme janë gjobat për këtë lëshim.⁸

8. Ligji për pastërti publike <https://tinyurl.com/jnu3aypt>

Si të veproni në rast të stuhisë së borës

- ▶ Informohuni rregullisht dhe me kohë për stuhitë e mundshme të borës në mjedisin tuaj përmes kanaleve zyrtare të informimit të institucioneve, mediave, internetit.
- ▶ Këshilla bazë është të qëndroni në shtëpi ose në një ambient/objekt tjetër të brendshëm që është i ngrohur, të jeni të veshur mirë dhe në gatishmëri. Sigurohuni që fëmijët, të moshuarit, personat me aftësi të kufizuara të jenë në vend të sigurt dhe të ngrohtë.
- ▶ Sigurohuni që kafshët tuaja shtëpiake të jenë me ju ose në një dhomë të mbyllur ose me ngrohje. Kufizoni qëndrimin e tyre jashtë.
- ▶ Nëse jeni duke lëvizur nëpër borë të thellë, lëvizni me kujdes, mos nxitoni, pushoni, në mënyrë që të reduktoni rrezikun e mbingarkesës së trupit dhe sulmit të mundshëm në zemër. Nëse jeni të detyruar të lëvizni nëpër dëbore, kini kujdes në shpatet, pjerrësia e të cilave është mbi 25 gradë.
- ▶ Nëse lëvizni në sipërfaqen e ngrirë, lëvizni me kujdes, me hapa më të vegjël, të ashtuquajtur, ecje pinguini. Nëse rrëshqitni, përpiqueni të mos bini me pëllëmbët e hapura, por anash, për të parandaluar dëmtime më të rënda.


- ▶ Shmangni lëvizjen pranë shtyllave, pemëve të larta, strukturave metalike për shkak të rrezikut të rënies së sasive të mëdha të borës dhe/ose akullit.
- ▶ Nëse jeni të ekspozuar ndaj të ftohtit dhe temperaturave të ulëta për një kohë të gjatë, mund të ndodhë ngrirja në trup dhe mund të ndodhë hipotermie, ulja e temperaturës së trupit për shkak të të ftohtit dhe ftohjes së trupit. Simptomat e hipotermisë përfshijnë dridhje, lodhje, përgjumje, konfuzion dhe çorientim, vështirësi në të folur, rrahje zemre etj. Prandaj, është e nevojshme të fillohet procedura e ngrohjes së trupit me mbulesa, batanije, rroba të thata, jastëkë elektrikë, foli termike etj., transferimi në një dhomë të ngrohur, ngrohja e pjesës qendrore dhe periferike të trupit, dhënia e pijeve të nxehta dhe transferimi në institucionin shëndetësor për ofrimin e ndihmës profesionale mjekësore.

Përdorimi i automjetit në kushte dimërore

- ▶ Para fillimit të sezonit të dimrit është e nevojshme të kontrollohet automjeti dhe të përgatitet për përdorim gjatë kushteve të dimrit në rrugë, për shembull përdorimi i gomave dhe pajisjeve dimërore në periudhën nga 15 nëntori deri më 15 mars, kontrolli i të gjitha lëngjeve dhe antifrizit etj. Është e nevojshme të keni pajisje dimërore, si lopatë të vogël, kruese akulli, fshesë bore, kablllo për tërheqjen dhe nisjen e automjetit, batanije, bateri, doreza etj.
- ▶ Gjatë dimrit është e nevojshme të planifikoni udhëtimin tuaj jashtë qytetit në përputhje me kushtet e motit dhe parashikimet. Në numrin e telefonit 02/15555 ose në faqen e internetit amsm.mk të Shoqatës së Automjeteve mund të informoheni për gjendjen dhe qarkullimin në rrugët. Disa shoferë kanë kartë anëtarësimi për ndihmë në rrugë.
- ▶ Komunitet pastrojnë rrugët dhe rrugicat lokale në rajonin e tyre, ndërsa rrugët rajonale dhe nacionale pastrohen nga NP Rrugët e Maqedonisë.
- ▶ Kur udhëtoni në kushte dimërore, mos u mbivlerësoni dhe mos ndërmerrni rreziqe të panevojshme. Gjithmonë informoni kontaktet tuaja të afërta për oraret e nisjes dhe mbërritjes. Nëse është e mundur, mos udhëtoni herët në mëngjes

ose në mbrëmje vonë. Dëgjoni radio që transmeton njoftime për gjendjen e rrugëve. Me sa është e mundur, udhëtoni në rrugët kryesore, të cilat pastrohen më shpesh nga bora. Mbajeni celularin tuaj plotësisht të karikuar dhe përdorni karikues / bateri për mbushje. Nëse ka stuhi dëbore, mos u nisni për rrugë.

- ▶ Drejtoni me kujdes automjetin, duke përshtatur shpejtësinë tuaj sipas kushteve të rrugës. Nëse ka borë ose automjeti juaj prishet, thirrni ndihmën dhe qëndroni në automjet. Nëse automjeti punon gjatë pritjes për ndihmë ose nëse keni ngecur në kolonë, hapni pak dritaren për të ajrosur brendësinë e automjetit dhe për të shmangur helmimin nga monoksidi i karbonit.



STUHI ME BRESHËR DHE VETËTIMA

Këshilla të përgjithshme për mbrojtjen nga stuhi e shoqëruar me breshër dhe vetëtima

Stuhi e shoqëruar me breshër dhe vetëtima është karakteristikë e periudhës së verës dhe mund të bëjë dëme të konsiderueshme në të mirat materiale të qytetarëve, në bujqësi, pemëtari, vreshtari dhe sektorë të tjerë.

- ▶ Për t'u mbrojtur nga pasojat e stuhisë, kontrolloni vizualisht gjendjen e pemëve (stabiliteti, sëmundje) dhe krasitni rregullisht degët e pemëve që ndodhen në afërsi të shtëpisë ose ndërtesës tuaj, në mënyrë që të parandaloni rënien e pemës ose dëmtimin e objektit. Nëse duhet të prihet pema ose pemët, paraqisni kërkesë për prerje në komunën tuaj (nëse është në pronën tuaj) ose paraqisni kërkesë për prerje / krasitje në komunën tuaj (zakonisht këto janë departamentet e shërbimeve komunale ose ndërmarrjet publike komunale).

- › Si masë paraprake, përpiquni të shmangni qëndrimin ose parkimin e automjetit tuaj nën pemë që duken të paqëndrueshme.

Veprimi në rast të stuhisë së shoqëruar me breshër dhe vetëtima

- › Në rast të shkarkimit të fortë elektrik në atmosferë dhe gjëmimeve, qëndroni larg dritareve dhe instalimeve telefonike, shkëputni pajisjet nga priza, ndërpritni furnizimin me ujë, mos u shtrini ose u mbështetni në dysheme dhe mure betoni, mos iu afroni radiatorëve, mos bëni dush dhe mos lani enët.
- › Nëse jeni në automjet, qëndroni në të, ndizni të katër sinjalet ndriçuese, mbyllni dritaret, fikni radion, mos prekni objektet metalike brenda automjetit, parkoni larg pemëve, shtyllave, strukturave, tendave, bëni kujdes nga vërshime të rrëmbyeshme dhe sasi të mëdha të ujit etj. Nëse jeni në automjet kabriolet, largohuni menjëherë dhe kërkoni strehim adekuat.

Veprimi në rast rrufeje


- › Në rast të një goditje rrufeje mbi një anëtar të komunitetit tuaj ose një person tjetër, telefononi 194 Ndhimën mjekësore urgjente. Personi i prekur nga rrufeja nuk ka ngarkesë elektrike në vete dhe mund t'i afroheni dhe të kontrolloni funksionet e tij vitale. Nëse jeni të trajnuar për ndihmën e parë, kontrolloni nëse personi po merr frymë dhe nëse zemra e tij funksionon. Nëse ka ndërprerje në frymëmarrje ose funksion të zemrës, kryeni frymëmarrje artificiale. Lëndime të tjera të këtij personi mund të përfshijnë djegie të pjesëve të prekura nga rrufeja, si dhe fraktura. Kujdesuni në mënyrë përkatëse nëse keni pajisje për ndihmë të parë.

Veprimi pas motin me stuhi

- › Pas përfundimit të stuhisë, nëse lejohet dhe rekomandohet nga autoritetet, mund të ktheheni në pronën tuaj. Kryeni një kontroll fillestar vizual të shtëpisë/objektit dhe nëse vëreni dëme të dukshme, njoftoni institucionet kompetente për inspektim dhe vlerësim të shpejtë të dëmit.

- ▶ Kontrolloni infrastrukturën pranë shtëpisë ose objektit tuaj. Nëse ka ndërprerje, njoftoni autoritetet komunale, shërbimet komunale ose operatorët e telefonisë dhe internetit për të riparuar ndërprerjet.
- ▶ Nëse shtëpia ose ndërtesa juaj është e dëmtuar dhe nuk mund të përdoret, atëherë komuna është e detyruar t'ju sigurojë strehim dhe kujdes urgjent.⁹
- ▶ Raportoni dëmet në komunë ndërsa komisioni komunal për vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore do të dalë në terren dhe do të bëjë vlerësimin sipas Metodologjisë së vetme për vlerësimin e dëmeve. Ndihma mund të jetë në formën e ndihmës direkte financiare, ose asistencës me ulje, përkatësisht lirim nga obligimet tatimore, të cilat jepen pa detyrim kthimi.

⁹. Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë. Tekste të pastuara editoriale. Ligji për mbrojtje dhe shpëtim (tekst i konsoliduar). Neni 86. http://www.dzs.gov.mk/public/storage1/files/zakon_2.pdf



RRËSHQITJE TOKE

Këshilla të përgjithshme për mbrojtje nga rrëshqitja e tokës

Një pjesë e konsiderueshme e territorit të Republikës së Maqedonisë së Veriut (20%) është e ekspozuar ndaj rrezikut nga rrëshqitja e tokës dhe paraqitjes së shkëmbinjve dhe dheut për shkak të relievit dhe kryesisht terrenit kodrinoro-malor. Në vend janë evidentuar më shumë se 400 rrëshqitje dheu.¹⁰

- ▶ Nëse jetoni ose planifikoni të jetoni në një zonë që është në rrezik të rrëshqitjeve të tokës dhe paraqitjes së rrëshqitjeve të dheut, rrëshqitjeve të shkëmbinjve ose gurëve dhe erozioneve, duhet të informoheni te autoritetet kompetente komunale (sektorët për urbanizëm, çështje komunale, mbrojtje dhe shpëtim, etj.) ose qendrat rajonale për menaxhim të krizave dhe departamentet rajonale të Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim. Pyetini ata për rrezikun, ngjarjet dhe pasojat në të kaluarën, kërkonte plane urbanistike, harta të rreziqeve ose vlerësime të rrezikut dhe kërcënimeve.

10. https://www.moepp.gov.mk/wp-content/uploads/2016/12/STUDIJA_PRIRODA.pdf fq. 71

- › **Shmangni ndërtimin e strukturave në terrene dhe shpate të pjerrëta, pranë kanaleve kulluese dhe kanaleve të rrëmbyeshme, etj. Megjithatë, nëse planifikoni të ndërtoni objekt të ri, përpara se të filloni punimet e ndërtimit, bëni një rilevim gjeo-mekanik të tokës dhe zbatoni masat e nevojshme.**
- › Nëse ndodh rrëshqitje dheu pranë shtëpisë ose ndërtesës suaj, konsultohuni me institucionet kompetente për sigurinë e objektit dhe merrni masa shtesë mbrojtëse strukturore dhe jo-strukturore, nëse është e mundur.
- › Mundohuni të mësoni shenjat dhe dukuritë e një rrëshqitjeje të mundshme, p.sh. zhurma të çuditshme dhe kërcitje e plasaritje të tokës ose çarje në objekt, vija të shkarjes së tokës.

Veprimi në rast të rrëshqitjes aktive të tokës

- › **Nëse dëgjoni këto tinguj të çuditshëm ose vini re të çara dhe vija të shkarjes së tokës, do të thotë se ka një proces aktiv rrëshqitjeje dheu. Nëse keni trup uJOR afër (përrua, lumë, pellg), do të vini re se uji bëhet me baltë, i turbullt, ka një rrjedhje më të madhe dhe më të shpejtë etj. Plasaritjet në ndërtesë zgjerohen, kështu që dyert dhe dritaret nuk do të mund të hapen**

ose kornizat/arkat e tyre do të shtrembërohen, tubat dhe kabllot e furnizimit dhe kullimit do të zhvendosen dhe ndërpriten.

- ▶ Nëse procesi i rrëshqitjes së dheut ka filluar ose në rast se njëkohësisht paraqitet stuhi ose stuhi me shi të rrëmbyeshëm, mos bini në gjumë në shtëpi ose në objekt, qëndroni zgjuar, monitoroni në mënyrë aktive situatën përmes radios, televizionit ose internetit dhe përgatituni të dilni shpejtë nga shtëpia ose ndërtesa. Për këtë rast njoftoni Qendrën për Menaxhim me Kriza në numrin e telefonit 195 (112) dhe planifikoni të evakuoheni në një vend të sigurt. Tregojuni të afërmeve dhe miqve tuaj, fqinjëve të afërt, gjithashtu kontrolloni nëse ndonjëri prej tyre ka nevojë për ndihmë shtesë për t'u larguar shpejt, p.sh. të moshuarit, personat me aftësi të kufizuara etj. Merrni me vete kompletin për situata emergjente, dokumentet e identifikimit dhe dokumentacionin për pronësi, gjëra të vlefshme që mund të merrni me vete nëse jeni me makinë. Mos harroni për kafshët shtëpiake.
- ▶ Shkoni në lokacionin që e keni identifikuar më parë si vend të sigurt, ndiqni udhëzimet e institucioneve kompetente ose shkoni në një vend që është më larg zonës. Qëndroni larg trajektores së rrëshqitjes së dheut dhe kini kujdes nga vërshimet, rrëshqitjet e dheut, rrëshqitjet e shkëmbinjve, përmytjet dhe mos lëvizni pranë shkëmbinjve, mureve etj. Kur largoheni nga lokacioni, përgatituni për tollovi dhe

ngecje, kështu që qëndroni të qetë dhe planifikoni lëvizjet dhe veprimet tuaja.

- ▶ Nëse rrëshqitja e dheut ka ndodhur pranë jush, kontrolloni nëse ka të lënduar ose nëse dikush ka nevojë për ndihmë dhe informoni autoritetet kompetente.
- ▶ Në rast të pasojave të papritura dhe të padëshiruara nga rrëshqitja e dheut, keni të drejtë t'i largoni ato, gjë që detyrimisht bëhet nga komunat dhe Qyteti i Shkupit, si pjesë e funksioneve operative të masave për mbrojtje dhe shpëtim dhe përmes forcave hapësinore për mbrojtje dhe shpëtim, kryet zbulimi i objekteve/rrënoja, lokalizimi i personave nën rrënoja, sigurimi i konstruksioneve të pjesëve të dëmtuara dhe të zhvendosura të objekteve për të parandaluar rrënimin shtesë, marrjen e masave për mbrojtje nga rreziqet shtesë, shpëtimin e personave nën rrënoja, dhënien e ndihmës së parë dhe nxjerrjen e të mirave materiale.

Veprimi pas rrëshqitjes së dheut

- ▶ Pas ngjarjes, kthehuni në pronën tuaj, vetëm nëse lejohet dhe rekomandohet nga institucionet kompetente. Kryeni kontroll fillestar vizual të shtëpisë/objektit dhe nëse vëreni dëme, njoftoni

institucionet kompetente për inspektim dhe vlerësim të shpejtë të dëmit.

- ▶ Nëse miratohet, kthehuni në shtëpinë ose objektin tuaj. Kontrolloni infrastrukturën pranë shtëpisë ose objektit tuaj. Nëse ka ndërprerje, njoftoni autoritetet komunale, shërbimet komunale ose operatorët e telefonisë dhe internetit për të riparuar ndërprerjet. Sa më shpejt të jetë e mundur, mbillni pemë për të stabilizuar tokën dhe ndërmerrni masa të tjera strukturore.
- ▶ Nëse shtëpia ose ndërtesa juaj është e dëmtuar dhe nuk mund të përdoret, atëherë komuna është e detyruar t'ju sigurojë strehim dhe kujdes urgjent¹¹.
- ▶ Raportoni dëmet në komunë ndërsa komisioni komunal për vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore do të dalë në terren dhe do të bëjë vlerësimin sipas Metodologjisë së vetme për vlerësimin e dëmeve. Ndhimja mund të jetë në formën e ndihmës direkte financiare, ose asistencës me ulje, përkatësisht lirim nga obligimet tatimore, të cilat jepen pa detyrim kthimi.

11. Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë. Tekste të pastruara editoriale. Ligji për mbrojtje dhe shpëtim (tekst i konsoliduar). Neni 86. http://www.dzs.gov.mk/public/storage1/files/zakon_2.pdf

KONTAKTI ME INSTITUCIONET KOMPETENTE

Qendra për
Menaxhim me
Kriza



Drejtoria për
Mbrojtje dhe
Shpëtim



Njësitë e
vetëqeverisjes
lokale



Kryqi i Kuq i
Republikës së
Maqedonisë së
Veriut



Organizatet
komunale të Kryqit
të Kuq



SHTOJCA 1 - PLANI PËR SITUATA EMERGJENTE

PLAN PËR SITUATA EMERGJENTE (dita / muaji / viti)
Adresa E Komunitetit
<u>Rruga, kodi postar</u>
<u>Qytet / fshat / vendbanim</u>
<u>Telefon / faks / email / faqe interneti</u>
<u>Koordinatat</u>

ANËTARËT E KOMUNITETIT

Emri dhe mbiemri:

Numri i telefonit celular:

e-mail:

Llogaritë e mediave sociale:

Grupi i gjakut: (rretho)

A+ / A- / B+ / B- / AB+ / AB- / O+ / O-

Gjendja specifike mjekësore (diagnoza / terapia):

Informacione të tjera mjekësore:

Mjeku amë/specialist:

Emri/mbiemri dhe informacion për kontakt:

Nevojë tjetër specifike:

KAFSHË SHTËPIAKE

Emri / raca / specie:

Ngjyra / karakteristikat specifike:

Numri i ID-së:

Çipi:

KONTAKT I PËRBASHKËT NË RAJONIN

Emri dhe mbiemri:

Numri i telefonit celular:

E-mail:

Llogaritë e mediave sociale:

KONTAKT I PËRBASHKËT JASHTË FUSHËS

Emri dhe mbiemri:

Numri i telefonit celular:

E-mail:

Llogaritë e mediave sociale:

SKICË PËR LARGIM TË SHPEJTË NGA SHTËPIJA / NDËRTESA

Data e përgatitjes:

Data e përditësimit:

Personi përgjegjës:

VEND TAKIMI NË ZONË

Rruga, kodi postar

Qytet / fshat / vendbanim

Telefon / faks / email /
faqe interneti

Koordinatat

**DOKUMENTAT E IDENTIFIKIMIT DHE DOKUMENTACIONI
PRONËSOR**

Lokacioni i ruajtjes:

Kopje: po / jo vend-ruajtja

Kopje digjitale: po / jo vend- ruajtja

Personi përgjegjës:

KOMPLET PËR SITUATA EMERGJENTE

Lokacioni i ruajtjes:

Personi përgjegjës:

Data e përfundimit / përditësimit:

PAJISJE PËR NDIHMË TË PARË

Lokacioni i ruajtjes:

Personi përgjegjës:

Data e përfundimit / përditësimit:

NUMRA TË RËNDËSISHËM TELEFONIK

Qendra për Menaxhim me Kriza - 195 (112)

Policia - 192

Brigada e zjarrfikësve - 193

Ndihma mjekësore urgjente - 194

Këshillë:

Sa herë që telefononi një nga numrat e shërbimit për situata urgjente, përgjigjuni pyetjeve të operatorit. Duhet të jeni të qetë dhe të flisni qartë. Përgjigjet tuaja duhet të jenë të shkurtra dhe të sakta. Prezantoni veten, tregoni se çfarë ndodhi, tregoni vendndodhjen dhe adresën, nëse ka të lënduar apo viktimë. Mos e ndërprisni thirrjederisa operatori t'ju thotë.

NUMRAT E SHËRBIMEVE KOMUNALE DHE OPERATORËVE

Ujësjiellës

EVN

Ngrohje

Furnizimi me gaz natyror

Telefonia

Internet

Operatorë të tjerë

SHTOJCA 2 - DOKUMENTAT E IDENTIFIKIMIT DHE DOKUMENTACIONI PRONËSOR

#	Lloji i dokumentit	Bartës (emri dhe mbiemri)	Numri i dokumentit	Vlefshmëri	Lëshuar nga	Fotokopje (po / jo)	Kopje elektronike (po / jo)
1	Dokument udhëtimi						
2	Letërnjoftim						
3	Patentë shoferi						
4	Legjitimacion i nxënësit studentit / Indeks						
5	Librezë ushtarake						
6	Dokument identifikimi për kafshën shtëpiake						
7	Llojet e tjera të dokumenteve personale						

8	Certifikatat e lindjes / martesës / kurorëzimit e vdekjes						
9	Dëshmi për pronësinë e shtëpisë / pronës						
10	Dokumentet kadastrale						
11	Testament						
12	Autorizim						
13	Diploma						
14	Certifikata						
15	Licenca						
16	Certifikatë						
17	Kartela bankare						
18	Librat e depozitave të kursimeve						
19	Dokumente për hua/ kredi						
20	Dokumente tatimore						
21	Polica e sigurimit						
22	Leje qarkullimi, karton jeshil, leasing						
23	Leje për ruajtjen/ mbajtjen e armëve						
24	Librezë shëndetësore, kartë e sigurimit shëndetësor etj.						

25	Diagnoza, terapia dhe recetat për të sëmurët kronikë						
26	Zgjidhje për lirim nga pagesa e shërbimeve shëndetësore, mjete ndihmëse ortopedike, statusit të personit me invaliditet etj.						
27	Dëshmi për vaksinimin e fëmijëve						
28	Certifikata e vaksinimit për KOVID-19, etj.						
29	Dëshmi për pronësi të veprave të artit dhe objekteve me vlerë						
30	Dokumente të tjera						

Informacione rreth projektit

Projekti “Përmirësimi i kapacitetit për menaxhim me kriza të komunave në Maqedoninë e Veriut” synon të forcojë menaxhimin strategjik me kriza në tetë komuna të zgjedhura, dhe të tregojë procesin e zhvillimit të planeve strategjike lokale për zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësi dhe katastrofa. Përmes projektit do të analizohet struktura ligjore dhe institucionale e sistemit për menaxhim me kriza, rolin e komunave që parashikon, dhe do të identifikohen boshllëqet dhe sfidat sistematike. Projekti financohet nga Mbretëria e Bashkuar, përmes Ambasadës Britanike në Shkup.

Për më shumë informacion në lidhje me projektin, kontaktoni:

Misha Popoviq, Hulumtues i lartë
misha@idscs.org.mk

Marko Pankovski, hulumtues
pankovski@idscs.org.mk

Sara Janeska, hulumtuese e re
sara@idscs.org.mk

Informacione rreth IDSCS-ë

Idscs është tink tenk organizatë, që hulumton Zhvillimin e qeverisjes së mirë, sundimin e së Drejtës dhe integrimet evropiane të maqedonisë. Idscs ka mision të ndihmojë përfshirjen qytetare Në vendimmarrje dhe të forcojë kulturën politike Participative. Përmes forcimit të vlerat liberaliste, Idscs kontribuon në bashkëjetesën ndërmjet Diversiteteve.

Të dhëna për kontakt, për IDSCS

Adresa:

rr. Miroslav Krlezha nr. 52/1 / 2, 1000 Shkup

Tel. nr./ faks:

+389 2 3094 760

Posta elektronike:

contact@idscs.org.mk

Informacione për autorin

mr. Vasko Popovski është konsulent dhe praktikues i pavarur me përvojë shumë vjeçare në fushat e menaxhimit me rreziqet nga katastrofat, menaxhimi me kriza, inovacione me rezistencë. Ekspertiza e tij në fushat profesionale të veprimtarisë shtrihet në vendet e rajonit të Evropës dhe Azisë Qendrore dhe Juglindore. Ka kryer fakultetin juridik, studime pasuniversitare në shkencat politike dhe është kandidat për doktoraturë në shkencat e sigurisë. Gjatë vitit 2018/2019, si bashkëpunëtor i Fulbright dhe shkencëtar i ftuar, ishte pjesë e ekipit të Qendrës për Studimin e Katastrofave në Universitetin e Delaware, SHBA, ku realizoi pjesë të kërkimit të tij shkencor mbi temën e rezistencës dhe modelin e një shoqëri rezistente dhe mori pjesë në realizimin e kurrikulës mësimore.

